

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7171
E mërkurë, 24 prill 2024
Çmimi 0.50 €

Kosova ka nevojë
për mbështetje
të vazhdueshme
nga shteti çek

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHTIMI I VOTIMIT NË VERI, KTHIM NË SITUATËN E PARA NJË VITI

FAQE 4-5



Nuk ka dyshim se bojkotimi i votimit më 21 prill, për largimin e kryetarëve shqiptarë në katër komunat me shumicë serbe në veri

të Kosovës, ishte "i suksesshëm", por lind pyetja se kush fitoi e kush humbi? Arton Demhasaj, nga organizata joqeveritare "Çohu",

konsideron se bojkotimi i votimit nuk i solli asgjë të mirë komunitetit serb. Sipas tij, fitues është presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić

DASH-i: PROBLEMET ME PAVARËSI TË GJYQËSORIT, KORRUPSIONI DHE KUFIZIMET NË LIRI TË MEDIEVE, NDËR SHQETËSIMET KRYESORE NË KOSOVË

F. 3



FRANCA: DUHET TË ORGANIZOHEN SHPEJT ZGJEDHJE NË VERI TË KOSOVËS

F. 3

AKTUALE



TË PAKTËN 10 SULME XHIHADISTE U PARANDALUAN NË EVROPË MË 2023

F. 2

AMBASADORI I BRITANISË PËRKRAH PUNËN E PROKURORISË SPECIALE, DHURON DONACION PËR TA LEHTËSUAR PUNËN E PROKURORËVE

F. 6

TRANSFORMOHEN RRËNJËSISHT SALLAT OPERATIVE NË NEUROKIRURGJI DHE KIRURGJI VASKULARE

F. 6

EKONOMI



BSPK-ja VLERËSON ROLIN E BE-së PËR NGRITJEN E MIRËQENIES SOCIALE DHE EKONOMIKE NË KOSOVË

F. 8

LIBURN ALIU MOHON AKUZAT PËR FALJEN E DHJETËRA MILIONË EUROSH BORXHE PËR AMBALAZHUESIT E UJIT

F. 8

SPORT



SOT MËSOHEN FINALISTET E KUPËS NË FUTBOLL

F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Franca: Duhet të organizohen shpejt zgjedhje në veri të Kosovës

PRISHTINË, 23 PRILL - Ambasadori francez në Kombet e Bashkuara, Nicolas de Riviere, ka thënë se në veriun e Kosovës duhet të organizohen shpejt zgjedhje, me pjesëmarrje të të gjitha komuniteteve, për t'i zgjedhur kryetarët e rinj të katër komunave me shumicë serbe. "Franca rikujton se tërheqja e kryetarëve të zgjedhur me vetëm 3 për qind të votave do të ishte mënyra më e shpejtë për rivendosje të demokracisë përfaqësuese në

katër komunat në veri dhe do të jetë shenjë e shtensionimit të situatës". Ai i ka bërë këto deklaratë në një seancë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të organizuar për të diskutuar për raportin gjashtëmujor të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, për punën e misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Deklarata e tij vjen një ditë pas mbajtjes së një votimi në katër komunat në veri të Kosovës, për të

larguar apo jo kryetarët atje. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka thënë se iniciativa për largim ose jo të kryetarëve ka dështuar, pasi në këtë proces kanë votuar 253 prej 46.556 qytetarëve që kanë pasur të drejtë vote. Për të qenë i suksesshëm procesi, do të duhej të votonin 50 për qind plus 1 votues. Kjo nënkupton se kryetarët aktualë në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, do t'i vazhdojnë mandatet e tyre.



Të paktën 10 sulme xhihadiste u parandaluan në Evropë më 2023

BRUKSEL, 23 PRILL - Inteligjenca perëndimore i ka parandaluar të paktën 10 sulme xhihadiste nëpër Evropë më 2023, ka thënë agjencia holandeze e inteligjencës, AIVD, të martën. Sipas saj, lufta e nisur në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, e ka rritur kërcënimin për sulme të tjera. Në kuadër të sulmeve është paraparë therja e njerëzve në mënyrë rastësore, sulme në ndërtesa dhe ngjarje specifike, ka



thënë AIVD në raportin e tij vjetor, pa dhënë më shumë hollësi. "Kanë qenë dy çështje mobilizuese: shkatërrimi i Kuranit në Holandë dhe shtetet e tjera evropiane, si dhe konflikti në mes

të Izraelit dhe Hamasit", ka thënë agjencia holandeze. Suedia e ka rritur alarmin për rrezik nga terrorizmi në të dytin më të lartë në vend, pas djegieve të Kuranit - librit të shenjtë për myslimanët - dhe akte të tjera me qëllim të dëmtimit të librit, çka ka zemëruar myslimanët dhe ka nxitur kërcënime prej xhihadistëve. Në tetor dy tifozë suedezë të futbollit janë qëlluar për vdekje në Bruksel. Akti dyshohet të jetë kryer prej një burri që e ka identifikuar veten si anëtar i grupit ekstremist

Shteti Islamik. Po në tetor të vitit të kaluar, një 20-vjeçar e ka therur për vdekje një mësues dhe i ka plagosur rëndë dy persona në një shkollë në veri të Francës. Presidenti francez Emmanuel Macron e pati dënuar sulmin si "terrorizëm islamik". Izraeli dhe Hamasi luftojnë në Gazë që prej tetorit të vitit të kaluar. Lufta është nxitur prej sulmeve të militantëve të Hamasit në tokën izraelite, më 7 tetor, duke vrarë 1 200 njerëz dhe duke marrë peng 250 të tjerë.

Izraeli është përgjigjur me fushatë ushtarake, duke lënë të vdekur më shumë se 34 000 palestinezë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze. Agjencia holandeze e inteligjencës nuk ka treguar sa ka qenë numri i saktë i sulmeve që i ka parandaluar prej 7 tetorit. Agjencia holandeze kundër terrorizmit e ka rritur në dhjetor të vitit të kaluar shkallën e kërcënimit ndaj terrorizmit, për herë të parë që prej vitit 2019, duke e përmendur ndikimin e luftës në Gazë.

Zvicra raporton për rënie të madhe në vlerën e aseteve të ngrira ruse



BERN, 23 PRILL - Zvicra ka ngrirë asete ruse në vlerë 5.8 miliardë franga zvicerane, njoftoi të martën qeveria e saj. Kjo përbën një rënie të madhe e cila mund ta rrisë trysinë ndërkombëtare ndaj vendit neutral për të bërë më shumë për sanksionimin e Moskës për shkak të pushtimit të Ukrainës. Asetet e ngrira në fund të vitit 2023 shënojnë rënie nga 7.5 miliardë franga zvicerane të aseteve të ngrira në fund të vitit 2022. Arsyeya kryesore ishte një rënie e aksioneve dhe aseteve financiare

në vlerën e tregut, të cilat janë bllokuar, tha sekretariati shtetëror për Marrëdhënie Ekonomike. Kjo rënie pritet të nxisë kritika nga ndërkombëtarët se Zvicra nuk po bën sa duhet për të vendosur sanksione për ndëshkimin e Moskës për shkak të pushtimit të Ukrainës nga ajo. Megjithatë Zvicra i ka rritur përpjekjet për t'i luftuar kompanitë dhe individët që e përdorin shtetin e saj për t'u ikur sanksioneve, vendet e tjera duan që ajo të bëjë më shumë. Zvicra deri tani i ka miratuar të

gjitha masat evropiane, qëllimi i të cilave është t'ia pamundësojnë Rusisë marrjen e mallrave dhe teknologjisë për ushtrinë e vet, por Berni e ka zgjedhur edhe rrugën e vet. Dhoma e Ulët e Parlamentit të Zvicrës nuk pranoi javën e kaluar t'i bashkohej një taskë-force ndërkombëtare për vendosjen e sanksioneve ekonomike kundër Rusisë, pjesë e së cilës janë Shtetet e Bashkuara, Australia, Kanadaja, Komisioni Evropian, Franca, Gjermania, Italia, Japonia dhe Britania e Madhe.

Dhjetë të vdekur si pasojë e përplasjes së dy helikopterëve ushtarakë në Malajzi

KUALA, 23 PRILL - Dy helikopterë ushtarakë u përplasën në ajër dhe u rrëzuan si pasojë gjatë kryerjes së stërvitjeve të martën në Malajzi, duke i lënë të vdekur të gjithë 10 njerëzit në bord, njoftoi marina malajziane. Helikopterët po bënin ushtrime në një bazë të marinës në veri të vendit gjatë përgatitjeve për

festën e 90-vjetorit të marinës kur u përplasën, tha marina në një komunikatë për medie. "Vdekja e të gjitha viktimave u konfirmua në vendin e ngjarjes", tha ajo, duke shtuar se mbetjet mortore të tyre janë dërguar në spital për t'u identifikuar. Shtatë pjesëtarë të ekuipazhit ndodheshin në helikopterin

AW139, i cili shërben për operacione detare, njoftoi marina. Ky helikopter është prodhim i Agusta Westland, filialit të kontraktuesit italian të mbrojtjes, Leonardo. Tre pjesëtarë të tjerë të ekuipazhit ndodheshin në helikopterin e lehtë, Fennec, i

cili është prodhim i Airbusit evropian. Mediet vendore raportuan se AW139 u rrëzua pranë një kompleksi sportiv në bazën e marinës, derisa Fennec ra në një pishinë aty pranë. Marina malajziane tha se do ta nisë një hetim për ta mësuar shkaktarin e aksidentit.



DASH-i: Problemet me pavarësi të gjyqësorit, korrupsioni dhe kufizimet në liri të medieeve, shqetësimet kryesore për Kosovën



PRISHTINË, 23 PRILL - Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut thotë se nuk pati ndryshime domethënëse gjatë vitit 2023 për drejtat e njeriut në Kosovë. Ndër raportimet më të rëndësishme në lidhje me të drejtat e njeriut ishin problemet serioze me pavarësinë e gjyqësorit; kufizimet serioze ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së medieeve, përfshirë edhe dhunën apo kërcënimet ndaj gazetarëve; korrupsioni serioz i qeverisë; dhuna e gjerë me baza gjinore, përfshirë dhuna në familje, apo ndaj partnerëve; si dhe krimet e dhunshme, apo kërcënimet për dhunë ndaj pakicave etnike dhe komunitetet e tjera.

Raporti i Departamentit të Shtetit thotë se Qeveria e Kosovës ndërmoi hapa të besueshëm, por jo të vazhdueshëm për t'i identifikuar, hetuar, akuzuar dhe ndëshkuar zyrtarët që mund të kenë abuzuar me të drejtat e njeriut.

Situata me gjyqësorin dhe shqetësimi për korrupsionin

Megjithëse Kushtetuta e Kosovës parashikon një gjyqësor të pavarur, raporti thotë se gjyqësori nuk ka arritur të ofrojë gjithnjë një proces të drejtë. Me mangësi në llogaridhënien e zyrtarëve të drejtësisë, strukturat e gjyqësorit u ndikuan nga

ndërhyrjet politike, emërimet e debatueshme dhe mandatet e paqarta. Ndërkohë, shoqëria civile kritikoi qeverinë për ndërhyrje publike në pavarësinë dhe paanshmërinë e institucioneve të gjyqësorit, në veçanti për rastet e hetimit për korrupsion të zyrtarëve të qeverisë. Megjithëse legjislacioni i Kosovës parashikon ndëshkimin penal të korrupsionit të zyrtarëve, qeveria nuk e zbatoi ligjin me efektshmëri. Pati njoftime të shumta për korrupsion qeveritar dhe zyrtarët u angazhuan ndonjëherë në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Mungesa e një mbikëqyrjeje të efektshme ndaj gjyqësorit dhe një dobësi e përgjithshme në funksionimin e shtetit ligjor kontribuuan më tej në këtë drejtim.

Liria e shprehjes dhe liria e medieeve

Megjithëse Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës garantojnë lirinë e shprehjes, përfshirë të punonjësve të shtypit dhe medieeve të tjera, pati raportime të besueshme se disa zyrtarë publikë, politikanë, afaristë dhe elementë të botës së krimit, madje edhe grupet fetare, u përpoqën t'i frikësojnë përfaqësuesit e medieeve dhe përdorën dhunën apo kërcënimet ndaj gazetarëve. Shoqata e Gazetarëve (AJK) raportoi se është bërë vetë objektiv sulmesh kur ka dalë në mbrojtje të

gazetarëve dhe të medieeve. Shoqata raportoi se zyrtarët e qeverisë, përfshirë kryeministrin dhe drejtuesit e partisë në pushtet, u angazhuan në fushata për ta dëmtuar besimin e publikut te mediet. Me gati 60 raste sulmesh të raportuara gjatë vitit, gazetarët u shprehën se për shkak të trysisë nga politikanët dhe grupet kriminale, kaluan shpesh në vetëcensurim të raportimit të tyre.

Sulmet ndaj gazetarëve gjatë tensioneve në veri të Kosovës në muajt maj dhe qershor dëmtuan pajisjet, dogjën automjete dhe lënduan fizikisht punonjësit e grupeve të medieeve në terren. Gazetarët thanë se disa prej këtyre sulmeve ishin të drejtuara dhe të miratuara nga udhëheqësit politikë në veri të vendit, megjithëse ata kanë mohuar ndonjë përfshirje të mundshme. Raporti vë në dukje se qeveria serbe vazhdoi të mbajë struktura të paligjshme paralele të qeverisjes në zonat me shumicë serbe dhe se i përdor këto struktura për të influencuar këto komunitete dhe përfaqësuesit e tyre politikë.

Dhuna me bazë gjinore dhe të drejtat e grave

Dhuna me bazë gjinore njihet në legjislacion si formë diskriminimi, por mungon një përkufizim i saj për t'u përdorur në proceset penale dhe civile.

Përdhunimi dhe dhuna në familje njihen si vepra penale, por qeveria nuk e zbatoi ligjin me efektshmëri. EULEX-i vuri në dukje se gjykatat shpesh japin ndëshkime më të lehta se minimumi i parashikuar dhe agjencitë e zbatimit të ligjit rrallë morën masa për t'i mbrojtur të mbijetuarit dhe dëshmitarët.

Vazhdojnë të jenë të pakta gratë në funksione drejtuese në biznese, në polici, apo në Qeverinë e Kosovës dhe në përgjithësi vetëm një në pesë gra gjendet në tregun e punës.

Diskriminimi ndaj pakicave etnike

Diskriminimi me bazë racore apo etnike ndalohet nga Kushtetuta e Kosovës, por vazhduan raportimet për dhunë dhe diskriminim ndaj grupeve të pakicave etnike. Sipas Avokatit të Popullit, pati probleme në zbatimin e plotë dhe të efektshëm të ligjeve, si dhe mangësi në kapacitetet institucionale. Dhuna shoqërore, në veçanti diskriminimi në punësim, vazhdoi ndaj serbëve të Kosovës dhe grupeve të tjera të pakicave etnike. Grupet e pakicave u përballën me diskriminim të niveleve të ndryshme në arsim, shërbime sociale, përdorim të gjuhës, liri të lëvizjes dhe të drejta të tjera të garantuara me ligj. (Voa)



Dështimi i votimit në veri, kthim në situatën e para një viti

Nuk ka dyshim se bojkotimi i votimit më 21 prill, për largimin e kryetarëve shqiptarë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, ishte “i suksesshëm”, por lind pyetja se kush fitoi e kush humbi? Arton Demhasaj, nga organizata joqeveritare “Çohu”, konsideron se bojkotimi i votimit nuk i solli asgjë të mirë komunitetit serb. Sipas tij, fitues është presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq

PRISHTINË, 23 PRILL - Nuk ka dyshim se bojkotimi i votimit më 21 prill, për largimin e kryetarëve shqiptarë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, ishte “i suksesshëm”, por lind pyetja se kush fitoi e kush humbi? Pas mbylljes së vendotimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstatoi se procesi ka dështuar.

Lista Serbe dhe Beogradi zyrtar thanë se “është treguar një shkallë e lartë e unitetit të serbëve në Kosovë”, ndërsa Prishtina tha se “i ka përmbushur obligimet e saj”. Ky votim është dashur të jetë hapi i fundit drejt shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme në komunat me shumicë serbe në veri dhe shtensionimit të situatës atje.

Në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, kryetarët shqiptarë erdhën në krye të komunave në maj të vitit të kaluar për shkak se serbët, edhe atëherë, i bojkotuan zgjedhjet me ftesë të

Listës Serbe - partisë udhëheqëse të serbëve në Kosovë, e cila e ka mbështetjen e Beogradit.

Kriza disamujore e krijuar asokohe ishte arsyeja përse bashkësia ndërkombëtare ushtroi presion mbi Kosovën për të filluar organizimin e zgjedhjeve të reja si dhe ndaj përfaqësuesve politikë të serbëve që të merrnin pjesë në një proces të tillë.

Tani duket se gjithçka është kthyer në pikën e fillimit - kryetarët shqiptarë, të cilët nuk pranohen nga popullata shumicë serbe në veri të Kosovës, mbeten në pushtet.

Humbësit dhe fituesit pas bojkotit të votimit

Kryetari i Kuvendit të komunës së Mitrovicës së Veriut, Nexhad Uglanin, vlerëson se nuk ka fitues pas votimit të dështuar për largimin e kryetarëve shqiptarë. Sipas tij, komuniteti shumicë serb është në humbje.

“Është paradoksale që komunitetet joshumicë të kujdesen për shumicën”, thotë Uglanin, i cili ka qenë i përfshirë në punën e komunës së Mitrovicës së Veriut që nga themelimi i saj në vitin 2013.

Votimi për largimin e kryetarëve shqiptarë në komunat e veriut është organizuar në bazë të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës dhe për të qenë i suksesshëm është dashur të plotësohet opsioni “po” nga 50 për qind plus një votues.

Megjithatë, nga rreth 46 mijë zgjedhës të regjistruar, të drejtën e votës e kanë ushtruar vetëm rreth 250 persona.

Për Aleksandar Stojanoviçin nga organizata joqeveritare Qendra për Zhvillimin e Mjediseve Lokale, “të gjithë janë humbës” pas votimit të 21 prillit. “Që një shoqëri të funksionojë duhet të ketë një konsensus shoqëror. Shoqëria civile ka bërë thirrje një kohë të gjatë që të fillojë një dialog i përgjithshëm brenda shoqërisë kosovare dhe ndërmjet aktorëve të ndryshëm politikë, në mënyrë që shoqëria të arrijë një konsensus dhe, në fund, të pajtohet për veprime të sinkronizuara, kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme”, thotë Stojanoviç për “Radion Evropa e Lirë”.

Arton Demhasaj nga organizata joqeveritare “Çohu” konsideron se bojkotimi i votimit nuk i solli

asgjë të mirë komunitetit serb. “Humbësi kryesor në të gjithë këtë është komuniteti serb që jeton në ato katër komuna, sepse ata [qytetarët] tash nuk i kanë përfaqësuesit e tyre legjitimë”, thotë Demhasaj për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas Demhasajt, fitues është presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Bojkotimi i votimit, shton ai, tregon se komuniteti serb, i cili jeton në katër komunat në veri të Kosovës, është i dirigjuar nga politikantët e Vuçiqit. “Kjo mendoj se ndikon negativisht te ta për shkak se për komunitetin serb është më mirë të dalë e të votojë dhe t’i zgjedhë përfaqësuesit legjitimë sesa të mbetet kështu i bllokuar siç ka mbetur aktualisht”, thotë Demhasaj.

Çfarë thonë qytetarët?

Branko Baroviç nga Mitrovica e Veriut thotë se serbët nga veriu e kanë dëgjuar gjithmonë “shtetin e tyre - Serbinë” dhe se votimi i 21 prillit ishte një “mashtim” nga autoritetet e Kosovës. “Pjesëmarrja është dashur të jetë 50 për qind plus një votë. Edhe sikur të dilnim të gjithë, do të humbnim. Qyteti ishte mbushur me tyta të gjata [v.j.policë]... ndërsa njerëz nuk kishte”, thotë ai.

Millan Dimiq, po ashtu nga Mitrovica e Veriut, beson se

votimi nuk do të ndryshonte asgjë dhe se do të gjendej mënyra që kryetarët shqiptarë të mbeteshin në pushtet. “Na duhet të durojmë edhe pak, por mbase do të bëhet më mirë”, thotë ai. “Në katër komunat në veri jeton popullata serbe. Ata [kryetarët shqiptarë] nuk mund të jenë aty, nuk kanë asnjë bashkëpunim me popullin”, thotë Stefani, po ashtu nga Mitrovica e Veriut.

Mirkoja nga Leposaviqi thotë se serbët i dëgjuan përfaqësuesit e tyre politikë dhe iu përgjigjën thirrjes për bojkotim. “Njerëzit shkojnë në komunë vetëm nëse u duhet të marrin letra dhe kjo funksionon tani për tani. Por, duhet të ketë zgjedhje, që në komunë të jenë ata që zgjidhen nga populli dhe jo dikush i emëruar nga Kurti”, thotë ai.

Bashkëpunimi i mëtejshëm mes qytetarëve dhe autoriteteve lokale

Ranko Krivokapiq, banor i Mitrovicës së Veriut, thekson se nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë bashkëpunim mes serbëve dhe autoriteteve lokale aktuale. “Gjithçka që ata bënë vitin e kaluar ishte në dëm dhe kundër interesave të popullit serb”, thotë Krivokapiq. Uglanin thotë se kuvendi i

Kosova ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga shteti çek

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 PRILL - Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, kryesuar nga kryetari Bekë Berisha, priten të martën në takim anëtarët e Komisionit të Senatit për Punë të Jashtme, Siguri dhe Mbrojtje nga Republika e Çekisë.

Kryetari i Komisionit, Bekë Berisha, pasi u uroi mirëseardhje anëtarëve të delegacionit çek, i informoi lidhur me fushëveprimin e Komisionit dhe për gjendjen e sigurisë në Kosovë.

Sa i përket mjedisit të sigurisë në aspektin global dhe rajonal, Berisha vlerësoi se situata vazhdon të jetë e sfiduar dhe e paqëndrueshme që, sipas tij, ngjarjet gjeopolitike globale po kanë ndikim jashtëzakonisht të

madh edhe në rajonin tonë. "Edhe Kosova ka pasur kërcënime dhe sfida, sidomos me veprimet e shtetit serb, të cilat vijojnë të mbeten kërcënim kryesor në Ballkanin Perëndimor. Rasti më i rëndë destabilizues kundër shtetit të Kosovës ka qenë sulmi i datës 24 shtator 2023, kur jemi përballur me një sulm të përmasave të mëdha, me ç'rast ka mbetur i vrarë një zyrtar policor. Por, institucionet e Kosovës kanë treguar profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë të intervenimit", theksoi Berisha, duke shtuar se Kosova është e përkushtuar për vlerat dhe standardet euroatlantike.

Berisha, si dhe anëtarë të tjerë të Komisionit, gjatë diskutimit të tyre me delegacionin çek, theksuan faktin se janë mirënjohës për kontributin e madh të cilin e ka dhënë dhe vazhdon të japë ushtria çeke

në kuadër të misionit të NATO-s në Kosovë.

Anëtarët e Komisionit, Enver Dugolli, Rashit Çalaj, Shqipe Mehmeti - Selimi, Mefail Bajqinovci e Hisen Berisha, gjatë diskutimit të tyre theksuan faktin se Kosova ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga shteti çek, sidomos për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes. Po ashtu, ata kërkuan që shteti çek ta mbështesë Kosovën drejt anëtarësimit në NATO.

Me këtë rast u theksua nevoja e thellimit të bashkëpunimit për t'i arritur qëllimet e përbashkëta, për një ambient më të sigurt dhe të qëndrueshëm për gjithë rajonin.

Anëtarët e delegacionit çek, gjatë diskutimit të tyre, falënderuan deputetët për mikpritjen e tyre, ndërkaq theksuan rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh.

Pas përfundimit të këtij takimi, kryesuesit e të dyja komisioneve mbajtën konferencë për medie.

Pjesë e delegacionit çek ishte nënkryetari i Senatit të Parlamentit, Tomas Czernin, kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Siguri dhe Mbrojtje, Pavel Fischer, nënkryetarë dhe anëtarë të këtij Komisioni, si dhe ambasadori çek Bohumil Mazanek.

Të martën edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim anëtarët e Komisionit të Senatit për Punë të Jashtme, Siguri dhe Mbrojtje nga Republika e Çekisë.

Në këtë takim u diskutua për situatën e përgjithshme politike dhe të sigurisë në Kosovë dhe rajon si dhe për domosdoshmërinë e thellimit të bashkëpunimit të dyanshëm.

Kreu i Kuvendit vuri në pah aspiratat dhe perspektivën euroatlantike të Kosovës si dhe angazhimet e institucioneve për garantimin e paqes dhe sigurisë, në kohën kur shteti serb po angazhohet për destabilizim të vendit tonë dhe rajonit.

Konjufca shprehu mirënjohje për kontributin e gjatë dhe të vyer të shtetit çek ndaj Republikës së Kosovës, duke i falënderuar anëtarët e Komisionit për angazhimin në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet vendeve tona në fushën e parlamentarizmit, të sigurisë dhe mbrojtjes.

Anëtarët e Komisionit e falënderuan kryetarin e Kuvendit për mikpritjen dhe shprehën gatishmërinë e tyre për ta vazhduar bashkëpunimin dhe mbështetjen për Kosovën edhe në të ardhmen.



komunës do ta vazhdojë punën e tij dhe se do t'i përfaqësojë interesat e të gjitha komuniteteve, duke promovuar bashkëjetesën. Megjithatë, ai thekson se në terren ekzistojnë probleme politike. "Qytetarët janë shndërruar në marioneta klasike për thellimin e krizës politike", thotë ai dhe shton se "nuk ka udhërrëfyes" se në cilin drejtim do të lëvizin marrëdhëniet në mes të komunitetit serb dhe pushtetit vendor.

Stojanović, nga Qendra për Zhvillimin e Mjedisve Lokale, beson se komuniteti lokal i serbëve mund të bashkëpunojë

me autoritetet komunale në veri të Kosovës në një "formë të cunguar". "Për momentin, vetë komunitet nuk kanë as kapacitete të personelit për ta mundur funksionimin e duhur të tyre në të gjitha fushat. Ky është problemi më i madh esencial. Komunitet nuk funksionojnë me kapacitet të plotë, prandaj nuk mund të jenë në shërbim të qytetarëve", thotë Stojanović.

Në nëntor të vitit 2022, me iniciativën e Listës Serbe, serbët u larguan nga institucionet e Kosovës në veri të vendit, duke përfshirë edhe administratën lokale. Pas

ardhjes në pushtet të kryetarëve shqiptarë, nisi edhe punësimi i punëtorëve të rinj, por sektori civil thekson se ato administrata nuk janë ende funksionale.

Më herët këtë e ka konfirmuar për REL-in edhe drejtori aktual i Departamentit për Sport, Rini dhe Kulturë në komunën e Leposaviqit, Nenad Radosavljeviq. "Nuk kemi njerëz të kualifikuar për shpalljen e procedurave të tenderit... Kemi problem, po punësojmë njerëz nga komunat e tjera, por kjo nuk do të vazhdojë gjatë nëse nuk reagon Qeveria e Kosovës", ka thënë Radosavljeviq.

Si erdhi deri te bojkotimi?

Votimit për largimin e kryetarëve shqiptarë të komunave i ka paraprirë mbledhja e nënshkrimeve në kuadër të petitionit që është mbështetur nga Lista Serbe.

Rreth dhjetë ditë para votimit kjo parti ka njoftuar se tërhiqet nga i gjithë procesi, me arsyetimin se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, "ka bërë gjithçka që ai të mos ketë sukses".

Kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, ka thënë se, sipas të dhënave zyrtare, në veri të Kosovës janë rreth 46 000 votues me të drejtë vote, por se situata

në terren është ndryshe sepse, në muajt e fundit, "rreth 15 për qind e serbëve janë zhvendosur".

Qeveria e Kosovës i ka bërë thirrje Listës Serbe "të mos përhapë informata të rreme, të mos mashtrorë opinionin dhe të mos bëjë presion ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb në komunat në veri".

Gjithashtu, bashkësia ndërkombëtare i ka bërë thirrje Listës Serbe, por edhe përfaqësuesve të tjerë politikë të serbëve, që ta rishqyrtojnë vendimin e tyre.

UP-ja pezullon nga puna profesorin Xhevat Krasniqi, i dyshuar për ngacmim seksual

PRISHTINË, 23 PRILL - Rektori i UP-së mori vendim për pezullimin nga puna të profesorit Xhevat Krasniqi me efekt të menjëhershëm, sipas kornizës normative përkatëse, derisa të përfundojnë veprimet hetuese nga prokuroria e shtetit. Kështu është bërë me dije në një njoftim në faqen zyrtare të UP-së.

Po në njoftim theksohet se Këshilli i Etikës i UP-së refuzon sulmet brutale nga persona brenda dhe jashtë UP-së dhe kërkon përmbajtje dhe rezervim nga çfarëdo

ndërhyrje dhe sulm ndaj UP-së, sidomos nga anëtarët e stafit të UP-së. "Më datë 22 prill, Këshilli i Etikës është sulmuar në mënyrën më të ashpër, pa arsye dhe në baza personale nga individë, të saktësuar në Vendimin e Këshillit të Etikës, që rezultoi të jenë staf i portaleve, gazetarë, përfaqësues të OJQ-ve dhe staf akademik i UP-së. Mbi bazën e vendimit të Këshillit të Etikës dhe rekomandimit drejtuar Rektoratit, Rektori i UP-së mori vendim për pezullimin nga puna të Prof. Xh.K., me efekt të menjëhershëm, sipas kornizës

normative përkatëse, derisa të përfundojnë veprimet hetuese nga ana e prokurorisë së shtetit", thuhet në njoftimin e UP-së.

Lëvizja Feministe Studentore edhe të martën ka ndërmarrë një aksion simbolik duke vendosur në derën e zyrës së profesorit Xhevat Krasniqi disa shirita me të cilët zyra e tij është cilësuar si skenë krimi. Të enjten e javës së kaluar kjo Lëvizje ka ndërprerë ligjëratën e profesorit Xhevat Krasniqi, i cili nga disa studente është denoncuar për ngacmim seksual.



Ambasadori i Britanisë përkrah punën e Prokurorisë Speciale, dhuron donacion për ta lehtësuar punën e prokurorëve

PRISHTINË, 23 PRILL - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Prishtinë, Jonathan Hargreaves.

Në fillim të këtij takimi kryeprokurori Isufaj e falënderoi ambasadorin e Britanisë së Madhe në Prishtinë, Jonathan Hargreaves, për vizitën e tij në Prokurorinë Speciale, duke theksuar se prania e tij në këtë institucion është konfirmim i dëshmuar i mbështetjes për Prokurorinë Speciale dhe, për më tepër, mbështetje për të luftuar krimin dhe korrupsionin e nivelit të lartë.

Më tutje, kryeprokurori Isufaj i njoftoi të pranishmit për rolin, strukturën dhe funksionimin e

Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe për punët dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion për realizimin e mandatit të tij në konsolidimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Edhe në këtë takim kryeprokurori Isufaj potencoi se, pavarësisht prej sfidave me të cilat ballafaqohen, prokurorët e kësaj prokurorie përgjatë punës së tyre udhëhiqen vetëm nga vlerat e pavarësisë, profesionalizmit dhe etikës me qëllim që rezultatet e punës të arrihen me guxim dhe vetëm siç është përcaktuar me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi.

Me këtë rast kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë,



nënshkruan marrëveshje për pranimin e një donacioni - pajisje për videoincizimin e intervistimit të të pandehurve, dhuruar për PSRK-në nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Kryeprokurori Isufaj ka falënderuar ambasadorin Hargreaves për donacionin e dhënë, duke theksuar se kjo ndihmë është e çmuar dhe e rëndësishme për ta mbështetur punën e prokurorisë në luftimin

e krimeve dhe për t'i forcuar kapacitetet e tyre për të siguruar drejtësi.

Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, e falënderoi ambasadorin britanik edhe për mbështetjen e dhënë ndër vite në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale, etike dhe logjistike të Prokurorisë Speciale.

Ndërsa ambasadori Hargreaves ka shprehur mbështetjen e tij për kryeprokurorin Isufaj me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit dhe luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke potencuar gatishmërinë e Ambasadës Britanike për organizimin e trajnimeve për prokurorë dhe staf mbështetës, me qëllim të zbatimit të reformave ligjore dhe institucionale.

Transformohen rrënjësisht sallat operative në Neurokirurgji dhe Kirurgji Vaskulare



PRISHTINË, 23 PRILL - Nga sallat me mungesë të kushteve elementare, në salla të kompletuara si në aparaturë ashtu edhe në infrastrukturë moderne. Për herë të parë do të ketë filtra sterilë, të cilët do të ndikojnë drejtpërdrejt në shkurtimin e infeksioneve intrahospitalore.

Përmes investimeve janë shtuar edhe shërbime të reja, të munguara deri më tani në

Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Me aparatura të reja e moderne të gjeneratës së fundit, pacientëve do t'u mundësohet trajtim pa pasur nevojë për ndërhyrje të hapura operative, e cila rrit cilësinë e shërbimit dhe saktësinë në punë për mjekët në njërin anë dhe siguri më të madhe për pacientët në anën tjetër.

Investimi për transformimin

rrënjësor në infrastrukturë dhe aparaturë ka vlerë rreth tre milionë euro, ndërsa për një vit për trajtim mjekësor të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike janë shpenzuar tre milionë.

Ministria e Shëndetësisë mbetet e përkushtuar për ofrimin e kushteve sa më të mira për qytetarët në institucionet publike.

Muzeu Kombëtar është pasuruar edhe me një eksponat që ka vlerë historike për Kosovën

Prishtinë, 23 prill - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, i dhuroi dhe dorëzoi Muzeut Kombëtar të Kosovës, penën me të cilën u

nënshkrua vendimi i liberalizimit të vizave për Kosovën. Këtë dhuratë e pranoi zëvendësuesja e drejtorit të Muzeut, Vjollca Aliu.

Paraprakisht, pena e nënshkrimit të vendimit final mbi liberalizimin e vizave, i datës 19 prill 2023, i ishte dhuruar zëvendëskryeministrit

Bislimi nga eurodeputeti dhe ish-raportuesi për Kosovën mbi këtë proces pranë Parlamentit Evropian, Thijs Reuten, gjatë qëndrimit të tij në vendin tonë në fund të muajit të kaluar.

Ky objekt pritet të ekspozohet më tutje në Muzeun Kombëtar të Kosovës.



Potencohen sfidat dhe angazhimi i prokurorëve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe korrupsionit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 PRILL - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjiun me kryeprokuroret dhe përfaqësuesit e prokurorive të vendit, në të cilin kanë marrë pjesë edhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe përfaqësuesi i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

Temë qendrore e diskutimeve të këtij takimi ishte trajtimi i rasteve të dhunës në familje, ku u potencuan sfidat dhe angazhimi i prokurorëve në trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me veprat penale kundër dhunës në familje dhe korrupsionit.

Në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe nëpër të gjitha Prokuroritë Themelore, për rastet e dhunës në familje, janë të caktuar koordinatore nga radhët e prokurorëve, të cilët merren ekskluzivisht me këto raste dhe të cilët vazhdojnë me përkushtim dhe me urgjencë t'i trajtojnë të gjitha rastet që ndërlihen me veprat penale kundër dhunës në familje. Megjithatë, pas diskutimeve të përbashkëta, e me



qëllim të parandalimit dhe luftimit të kryerjes së këtyre veprave penale, u nxorën edhe konkluzionet që prokurorët e shtetit, në secilin rast ku ka bazë ligjore, ta kërkojnë caktimin e paraburgimit për rastet e dhunës në familje dhe armëmbajtjeve pa leje, si dhe të zbatojnë në mënyrë strikte

udhëzuesin për politikë ndëshkimore, ndërsa me qëllim të realizimit të mandatit të Prokurorit të Shtetit për hetimin e këtyre veprave penale, institucioneve të tjera t'u adresohen kërkesat për: Rritjen e buxhetit për shtimin e numrit të mbrojtësve të viktimave; Rritjen e buxhetit për shtimin e

strehimoreve për vendosjen e viktimave; Rritjen e kapaciteteve në Agjencinë për Forenzikë të Kosovës, si dhe rritjen e kapaciteteve të Institutit për Forenzikë Psikiatrike. Po gjatë këtij takimi u diskutua edhe për rastet e korrupsionit, për të cilat ushtruesi i detyrës së

Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, kërkoj rritje të efikasitetit. Ndër të tjera, gjatë këtij takimi u diskutua edhe për funksionalizimin e Zyrës për Rikthim të Aseteve, për planin për procedurat standarde të veprimtimit, si dhe u elaboruan të gjitha çështjet që bien në kompetencë të kësaj zyre.

PE-ja miraton heqjen e vizave për shtetasit e Kosovës që kanë pasaporta të Serbisë

PRISHTINË, 23 PRILL - Parlamenti Evropian të martën ka miratuar vendimin për liberalizimin e vizave për bartësit e pasaportave të Serbisë që jetojnë në Kosovë, të cilët pajisen me dokumente nga Drejtoria Koordinuese në Beograd. Bartësit e këtyre pasaportave nuk ishin përfshirë në liberalizimin e vizave në kohën kur Bashkimi Evropian i hoqi vizat për shtetasit e Serbisë.

Nga Aeroporti i Prishtinës nuk është e mundur të udhëtohet me pasaportë të lëshuar nga Drejtoria Koordinuese e MPB-së së Serbisë në Beograd për qytetarët e Kosovës sepse autoritetet e Kosovës e konsiderojnë të paligjshme. Megjithatë, poseduesit e këtyre pasaportave mund të udhëtojnë nga çdo vend i rajonit.

Komisioni Evropian në muajin nëntor të vitit të kaluar, kur rekomandoi heqjen e vizave edhe për bartësit e këtyre pasaportave, si arsyetim dha qëllimin që të gjithë qytetarët e rajonit të Ballkanit Perëndimor ta gëzojnë liberalizimin e vizave, pa marrë parasysh se çfarë pasaporte kanë. Ky propozim i Komisionit Evropian erdhi pasi ishte e qartë se nga 1 janari shtetasit e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në vendet e Schengenit.

Vendimi i së martës u miratua në seancën plenare të Parlamentit Evropian me 406 vota për, 97 kundër dhe 94 abstenime.



Ky votim në Parlamentin Evropian është hapi i fundit në këtë institucion të BE-së drejt vendimit për heqjen e vizave për bartësit e këtyre pasaportave. Raportin, i cili u votua të martën në seancë plenare, e ka përpiluar deputeti nga Slovenia, Matjazh Nemec.

Ai ka thënë se me raportin e tij nuk ka për qëllim të zgjidhë ndonjë çështje politike apo mospajtim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë por, siç u shpreh ai, një problem praktik dhe teknik për ta siguruar lëvizjen e lirë dhe për ta siguruar trajtimin e

barabartë. Ai madje tha se ky problem ishte krijuar nga vetë BE-ja në vitin 2009, kur u hoqën vizat për Serbinë, por jo edhe për bartësit e këtyre pasaportave dhe tash BE-ja duhet ta përmirësojë këtë gabim. Nemec theksoi në fjalimin e tij se ky vendim, i propozuar nga Komisioni Evropian, është mbështetur edhe nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të BE-së dhe ka pajtimin e Këshillit. Qeveria e Kosovës e kishte kritikuar dhe kundërshtuar propozimin për përfshirjen e këtyre pasaportave në

liberalizimin e vizave duke e quajtur "shkelje të integritetit territorial të Kosovës". Për më tepër, Qeveria e Kosovës kishte argumentuar se me një vendim të tillë BE-ja do të ndikojë negativisht në procesin e integritetit të serbëve të Kosovës.

Sipas Qeverisë së Kosovës, argumenti se serbët e Kosovës nuk janë përfshirë në liberalizim nuk qëndron pasi ata, sikur të gjithë shtetasit e tjerë të Kosovës, mund të pajisen me pasaporta biometrike të Kosovës me procedurë të

shpejtuar dhe me ato pasaporta mund të udhëtojnë pa viza në vendet evropiane.

Për Qeverinë e Kosovës problematik është edhe fakti se në pasaportat që i lëshon Drejtoria Koordinuese e Serbisë në Beograd shkruhen vendbanimet në territorin e Kosovës sikur të jenë në Serbi, që është në kundërshtim me marrëveshjet e arritura në dialog për shuarjen e strukturave paralele të Serbisë.

Por, argumentet e Kosovës nuk ishin marrë parasysh nga institucionet e Bashkimit Evropian, as nga Komisioni Evropian, nga Parlamenti Evropian e as nga Këshilli.

Pas votimit të sotëm në seancën plenare të Parlamentit Evropian, ka mbetur vetëm që Këshilli i BE-së ta formalizojë vendimin dhe ai të hyjë në fuqi.

Pikërisht për shkak se seancat plenare të kësaj jave janë të fundit në këtë përbërje të Parlamentit Evropian, edhe kishte presion kohor që votimi të përmbyllet në këtë seancë, sepse pas kësaj jave do të shpërbëhet Parlamenti Evropian, ndërsa seanca themeluese e përbërjes së re do të jetë në korrik, pas zgjedhjeve evropiane.

Sikur të mos ishte votuar këtë javë, gjithçka do të shtyhej për fundin e këtij viti. Tash mbetet të përmbyllet formalitetet në Këshill në mënyrë që vendimi të hyjë në fuqi.

BSPK-ja vlerëson rolin e BE-së për ngritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike në Kosovë

PRISHTINË, 23 PRILL - Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykollli, ka pritur në takim përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, udhëheqësen e Njësisë së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Anne-Sophie Huee, dhe ekspertin për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të Fondacionit Evropian për Trajnime, Matthias Themel. Përfaqësuesit e BE-së e informuan Hykollin për projektet dhe programet e BE-së që tashmë janë ngritur në Kosovë, sidomos për trajnimet lidhur me arsimin

profesional dhe ndërlidhjen e tij me tregun e punës, po ashtu edhe për rëndësinë e dialogut social në këtë çështje. Themel u ndërlidh edhe me çështjen e seminarit shkëmbyes trepalësh i cili pritet të mbahet në Bruksel prej 29 deri më 31 maj 2024 e që ka të bëjë me tranzicionin e gjelbër, në të cilin Hykollli do të marrë pjesë. Ndërsa Huee shpallti programet që Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë është duke i përkrahur dhe zhvilluar në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Hykollli i njoftoi të

pranishmit për organizimin sindikal dhe për veprimet sindikale të BSPK-së. Pos të tjerash, në takim u bisedua edhe për Këshillin Ekonomiko-Social dhe për Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, si dhe për angazhimin e BSPK-së në rrjedhat dhe në aktivitetet përkitazi me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të punëtorëve, po edhe për përfshirjen në projektet dhe në programet e BE-së. Kryetari Hykollli falënderoi përfaqësuesit e BE-së, Themel dhe Huee, për



praninë e tyre dhe për të gjithë përkushtimin e BE-së me përkrahje të drejtpërdrejtë dhe praktike

në drejtim të ngritjes së mirëqenies sociale dhe ekonomike të të punësuarve në Kosovë.

Liburn Aliu mohon akuzat për faljen e dhjetëra miliona eurosh borxhe për ambalazhuesit e ujit

PRISHTINË, 23 PRILL - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, në një intervistë për "Ekonomia Online", i ka quajtur shpifje raportimet e mediëve për shlyerjen e borxheve në forma të kundërligjshme kompanive që merren me ambalazhimin e ujit në Kosovë.

Aliu ka thënë se të gjitha këto akuzat janë politike dhe se raportimet nuk qartësojnë nëse ai është i përfshirë në këto akuzat. Ai fillimisht ka kërkuar sqarime se nga ka ardhur falja e këtyre miliona eurove, ku përfshihet edhe Naser Hafizi, zëvendësues i drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore. "E para kjo nuk është akuzë, është shpifje. Sikur të akuzon duhet të ketë një bazë, një farë lloji lidhje logjike. Kur flasim për borxh ata do të duhej të flasin një herë për sasinë. Pra thonë 90 milionë euro borxh apo si është ajo, si kanë ardhur tek ai 90 milionë euro. E dyta, ku lidhet kjo me ministrin Liburn Aliu që ata dëshirojnë me thanë, në çka lidhet, si e paskam falur unë, kam pasur ndonjë vendim siç ka qenë përpara, vendim për falje apo diçka tjetër. A ka pasur ndonjë vendim të tillë ndonjëherë nga ana ime? A ka



ndonjë marrëveshje me dikë, ku, me kënd? Vetëm le të dalin ta thonë, krejt në rregull. Por të gjitha janë shpifje dhe nuk kuptoj cili është motivi mbrapa. Mbase mund të jetë vetëm thjesht politik, po mund të jetë edhe çka tjetër", ka

thënë ai. I pyetur për publikimin e disa dokumenteve që e ndërlidhin me këto pretendime, Aliu tha se nuk vërtetojnë një gjë të tillë. Vendim të gabuar e ka quajtur edhe atë të ish-kryeministrit

Haradinaj për faljen e borxheve ambalazhuesve të ujit. "Ato nuk janë vërtetime të asaj. Ato shumë thjesht, nëse paska pasur hetim për këto, ku është hetimi, ku ka mbërritur? Unë mendoj që ai vendim i asokohshëm ku është

thënë falet borxhi nuk ka një bazë të caktuar ligjore, se nuk është i definuar borxhi, pra është dashtë të definohet cilin borxh. Mbi cilin udhëzim administrativ, mbi cilin ligj, si është kalkuluar ai borxh. Unë mendoj se këtu ka qenë një gabim asaj kohe me ra në një farë lloji, si të themi, gafe. Ku falet një borxh i cili nuk është as i rregulluar e as i kalkuluar. Nuk mund të ketë vendime politike të cilat mbulojnë këtë fushë. Është tejet gafë e madhe. Unë e quajta se është një daktilografim i dobët i pretendimeve të padijshme", ka thënë Aliu.

Ai ka shtuar se ekziston mundësia që zyrtarët të cilët janë akuzuar mund të dorëzojnë padi për shpifje, por që ai vetë si ministër nuk e ka ndër mend ta bëjë një gjë të tillë pasi, sipas tij, ai është një pretendim qesharak që do t'ia ulë "seriozitetin punës së tij". "Me sa di unë, zyrtarët përkatës që janë akuzuar, që është përfolur për ta, mbase edhe padisin. Vetë prej pozitës së ministrit me u marrë e me ra në këtë nivel qesharak të kësaj padie, me thanë të drejtën, më duket që pak edhe ia uli seriozitetin vetes me u marrë me një pretendim tejet joserioz dhe qesharak", ka thënë Aliu.

Komisioni për Mjedis miraton Projektligjin për performancën energjetike të ndërtesave

Prishtinë, 23 prill - Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, udhëhequr nga kryetarja Fitore Pacolli-Dalipi, mbajti mbledhjen e radhës, në të cilën, pas shqyrtimit, u miratua Projektligji për performancën energjetike të ndërtesave, duke e proceduar tutje për lexim të dytë në seancën plenare. Mbledhja vazhdoi lidhur me shqetësimet e ngritura nga deputeti Milazim Salijaj për tjetërsimin e pronës publike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" te Fakulteti Teknik. Deputeti Salijaj paraqiti vizitat e zhvilluara në institucionet

përkatëse nëpër të cilat ka kaluar keqpërdorimi dhe manipulimi i tjetërsimit të pronës publike të UP-së te Fakulteti Teknik. Ai theksoi se tjetërsimi i kësaj prone publike është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe, sipas tij, paraqet vepër penale. Përkitazi me këtë, komisioni njëzëri bëri thirrje që urgjentisht të punohet në këtë drejtim për zbardhjen sa më parë të mundshme të keqpërdoruesve të pronës publike të UP-së. Ndërkaq, kryetarja e këtij komisioni, Fitore Pacolli-Dalipi, njoftoi deputetët lidhur me iniciimin për ndryshimin

dhe plotësimin e ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për të cilin, siç tha ajo, do të punohet në mbledhjet e radhës. Po gjatë kësaj mbledhjeje u shqyrtua edhe kërkesa e banorëve të lagjes "Toukbaççe" në Prishtinë lidhur me tjetërsimin e disa burimeve ujore. Lidhur me këtë çështje, komisioni u pajtua që shqetësimet e banorëve t'i përcjellë me shkrim tek organet kompetente, përkatësisht te komuna e Prishtinës, te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në KRU Prishtina.



Kanti dhe çështja për paqen



Nga: Lea Ypi /
The Financial TIMES

Në një botë tjetër të mundshme, ndoshta më të parashikueshme sesa kjo botë në të cilën ne sot jetojmë, në vend që të merrja turr për çdo mëngjes për t'i kontrolluar lajmet e fundit mbi luftën e Rusisë në Ukrainë, rregullisht do ta ndiqja parashikimin e motit. Me padurim do ta prisja udhëtimin prej kohësh të planifikuar për në Kaliningrad, për të marrë pjesë në festën e ditëlindjes së filozofit tim të preferuar dhe, me sa duket, edhe të një prej të preferuarve të Vladimir Putinit: Immanuel Kant. Fluturimi për në Moskë dhe udhëtimi brenda vendit u rezervua për fund të këtij muaji dhe, në mënyrë joromantike, jokritike – disi e papërshtatshme për një kantiane – isha duke ëndërruar për shkuarjen time. Mos duhet të tentoj të imitoj shëtitjen legjendare të pasdites së Kantit nëpër qytetin e atëhershëm prusian – duke e përshtatur kohën time që të përkojë me të tijën, siç thuhet se kanë bërë banorët e Kënisbergut? A duhet të shkoj drejt qendrës së qytetit, në përpjekjen për të gjetur të famshmet “shtatë urat e Kënisbergut” – problemin matematikor të analizuar nga Leonhard Euleri i cili i vuri themelet e teorisë së grafikoneve? Mos duhet të ndalem për një selfi në brigjet e lumit Pregolja (dikur Pregel)? Apo, duhet të tentoj të vizitoj katedralen gotike të shekullit XIV?

Mbase më vonë. Sa për mua, vendi më i rëndësishëm i Kaliningradit është varri modest i Kantit. “Immanuel Kant / 1724-1804 / Filozof i shquar idealist borgjez. Lindi, jetoi pa u larguar dhe vdiq në Kënisberg”, thuhej në një pllakë të epokës sovjetike, e cila u vendos aty pak pas vitit 1947 – kur varri çuditërisht shpëtoi nga prishja. Në atë kohë, Kaliningrad – i cili gjatë luftës ishte bombarduar nga britanikët dhe nga sovjetikët – i nënshtrohej rindërtimit të pasluftës, me planet për ta kthyer në një qytet të marketingut sovjetik, të mbushur me statujat e Stalinit dhe me blloqet ndërtuara si me Lego. Varri i Kantit shpëtoi nga ndërhyrja e mrekullueshme e VV Lyubimovit (me shumë gjasë, emër i rremë) i cili i shkroi Izvestia-s, gazetës zyrtare të qeverisë, për të paralajmëruar autoritetet për rrezikun e afërt për varrin e filozofit. Kanti, donte t’ua përkujtonte ai, ishte cituar me respekt në Dialektikën e natyrës të Friedrich Engelsit, i cili e vlerësoi “veprën epokale” të Kantit për thyerjen e pikëpamjes “së ngurtësuar” teologjike të natyrës. Në një rast të rrallë të reagimit ndaj demokracisë nga poshtë, komiteti për lokacionet kulturore i Këshillit të Ministrave, vendosi të ruante varrin e Kantit dhe, për pasojë, edhe katedralen ku gjendej. Që atëherë, mënyra se si autoritetet dhe publiku i gjerë angazhohen për Kantin dhe për mendimin e tij, se si debatojnë, përvetësojnë – dhe në një farë

mase e shtrembërojnë – trashëgiminë e tij, ka ofruar një thjerrëz interesante përmes së cilës mund të hulumtohen disa nga tensionet më të gjera të marrëdhënies të Rusisë me Evropën, si dhe raporti i Evropës me vetveten. Në fillim të korrikut 2005, në prag të 750-vjetorit të Kaliningrad-Kënisbergut, universiteti lokal merr emrin Immanuel Kant. Të pranishëm ishin presidenti rus Vladimir Putin dhe kancelari gjerman Gerhard Schröder. Pati fjalime entuziaste dhe shtrëngime të forta të duarve. Kaliningradi, tha Schröderi, “tashti është qyteti më perëndimor i Federatës Ruse” dhe megjithëse kjo për disa ende “është e dhimbshme, është pjesë e historisë”. Qyteti kishte “shans të vërtetë për t’u bërë metropol i vërtetë evropian, duke kapërcyer kufijtë që janë vizatuar”. Duke e nënshtuar të kaluarën tragjike ndaj të ardhmes më shpresëdhënëse, mund të dëgjoheshin jehonat e tezës së vjetër të tregtisë “së ëmbël” [Doux commerce]: tregtia si parakusht për paqen e qëndrueshme. Në Kaliningrad/Kënisberg u thirrën te gjenialiteti dhe fryma e Kantit për ta vulosur atë bashkim të veçantë të arsyes gjermane dhe të pasionit rus – që më vonë u bë i njohur si Rrjedha e Veriut 1 dhe 2 [Nord Stream]. Kohët e fundit, një dekret presidencial i nënshtuar nga Putini urdhëroi përgatitjet për 300-vjetorin e Kantit. Një uebfaqe e dedikuar për këtë, ende thotë: “Studiuesit e nderuar do të mbledhen në qytetin ku profesor

Kanti lindi, jetoi, punoi dhe tani prehet, për të diskutuar mbi trashëgiminë e filozofit, ndikimin e ideve të tij në përparimin e shkencës dhe të shoqërisë moderne”. Jam njëra prej këtyre studiuesve. Ose, më saktë isha. Në shkurt 2022, Rusia e pushtoi Ukrainën dhe konferenca ndërkombëtare në të cilën do të merrja pjesë – mbledhja më e madhe e studiuesve të Kantit në botë – u zhvendos në Gjermani. Faqja e internetit për këtë ngjarje (tani e përditësuar) e dënoi luftën e agresionit të Rusisë, duke shpjeguar se vendimi për të mos udhëtuar në Kaliningrad u ndryshua me “supozimin e arsyeshëm” se kongresi “vepronte në interes të anëtarëve të vet dhe të qëllimit të shoqatës”. Kohët e fundit u angazhova në një tjetër eksperiment mendimi. A do ta anulonte Kanti kongresin në Kaliningrad? Duket e pamundur, duke gjykuar reagimin ndaj luftës së agresionit të Rusisë kundër vendit të tij – në fund të Luftës Shtatëvjeçare. Edhe pse Kanti ishte i pari që doli me përkufizimin e Iluminizmit të përthekuar në moton “Sapere aude!” (“Guxo për bindjet tua”), filozofi i shquar i shekullit XVIII dhe autori i Kritikës së arsyes së pastër nuk ishte i njohur për aktet e veta të guximit personal. Më 1757, Kënisbergu ishte nën pushtimin rus dhe Kanti i shkroi perandoreshës Elizaveta duke premtuar besnikërinë e tij ndaj saj. Në rastin e tradhtisë, tha ai, “do të informoj menjëherë autoritetet, por edhe do të

përiqem të kundërshtoj veprën”. Atëherë kishte mbetur një vend i zbrazët [në universitet] në logjikë dhe metafizikë, ndërsa Kanti kishte nevojë për mbështetjen e autoriteteve (dështoi). Dashuria për kombin nuk duhet të sakrifkohet kurrë për një karrige të rëndomtë në universitet, mund të thonë disa. Megjithatë, qyqarllëku mund të mos jenë shpjegimi i vetëm për mospërputhjen midis përbajtjes radikale të shkrimit të Kantit dhe sjelljes së tij më të moderuar personale. Arsyja më e thellë qëndron te kërkesat politike të teorisë së tij të lirisë. Të jesh i lirë, në kuptimin kantian, do të thotë të jesh në gjendje të krijosh një distancë kritike nga pasionet dhe prirjet e tua dhe të pyesësh veten nëse ato kontribuojnë në mendimin e “iluminuar”: dalja, siç thotë Kanti, nga “vetëdëmtimi i papjekurisë së njerëzimit”. Procesi i iluminizmit mbështetet në tri maksima: të mendosh për veten, të mendosh duke e vënë veten në vendin e gjithë të tjerëve, dhe gjithmonë dhe vazhdimisht të mendosh. Këto maksima, besonte ai, mund të avancoheshin përmes “përdorimit publik të arsyes”, një modus operandi që në thelb është i ndryshëm nga përdorimi “privat” që bëjnë njerëzit në profesionet e veta (le të themi si studentë, mësues, mjekë, politikanë, avokatë ose menaxherë të pronave). Teksa kjo e fundit është bërë premisë në pranimin e autoritetit, e para kërkon angazhimin pluralist, të paanshëm dhe kritik.

Është e vështirë të ndërlihdesh me aspiratat e Kantit në një epokë si e jona, ku shpirti publik vazhdimisht kërcënohet nga përplasjet mes interesave private. Mënyra jonë e komunikimit është më e gjerë dhe më gjithëpërfshirëse sesa në shekullin XVIII (për shembull, pjesëmarrja politike nuk kufizohet më formalisht vetëm te zotëruesit e pronave), por gjithashtu është më e cekët, më e sigurt në vetvete dhe më pak kritike. Mospajtimi manifestohet më shumë në aktet e zhurmshme të vetëshprehjes individuale (mundësisht të regjistruara në një telefon celular) dhe më pak në angazhimin kritik kolektiv.

Ashtu si ne, Kanti jetoi në një epokë krize që shquhej nga përparimet e mëdha në shkencë dhe në teknologji, por me një kolaps në vlera. Megjithatë, ai e krijoi rolin për arsyen si një kapacitet komunikues universal i cili përpiket të drejtë rrugën e mesme midis skepticizmit dhe dogmatizmit: midis besimit në asgjë dhe ndjekjes së verbër të trendëve. Ky koncept i arsyes duket më i vështirë për t'u ringjallur në shoqëritë tona të cilat ngufaten përderisa janë midis interesave shkatërrimtare dhe individualizimit në angazhimin politik.

Më 12 shkurt 2024, pothuajse dy vjet pasi Rusia pushtoi Ukrainën, guvernatori i Kaliningradit, Anton Alikhanov, në një konferencë deklaroi se përgjegjësia për luftën e fundit nuk i takonte askujt tjetër përveçse filozofit iluminist. Kanti, theksoi Alikhanovi, kishte "marrëdhënie të drejtpërdrejtë me kaosin global, me riorganizimin global me të cilin tash po përballemi"; veprat e tij kontribuan në një "situatë sociale dhe kulturore" në të cilën "Perëndimi ka shkelur të gjitha marrëveshjet që ishin arritur".

Nuk ishte hera e parë që Kanti tërhoqi zemërimin e nacionalistëve rusë. Në dhjetor 2018, kur qeveria e kreu një sondazh në internet për të riemërtuar aeroportin e Kaliningradit, Kanti ishte i preferuari – derisa një fushatë e shpifjes që e akuzonte si "rusofob" nuk çoi në dëmtimin e statujës së tij, me ngjyrën e hedhur mbi varrin e tij, si dhe me shkatërrimin e një pllake përkujtimore që shënonte vendin ku kishte jetuar. Megjithatë, këtë herë kishte ironi tragjike në fjalët e Alikhanovit se Kanti kishte "lidhje të drejtpërdrejtë me konfliktin ushtarak në Ukrainë". Kanti, në fund të fundit, njihet më shumë si autori i një prej esevë më të famshme kundër luftës, të shkruara ndonjëherë në historinë e filozofisë: Drejt paqes së përhershme, botuar më 1795. Teksa konfliktet shkatërrimtare kërcënojnë të zgjerohen shtrirjen e vet, nga Rusia/ Ukraina në Evropë dhe nga Izraeli/Palestina në pjesën tjetër të Lindjes së Mesme, rileximi i Kantit rezulton të jetë problematik, por ndoshta edhe i dobishëm.

Vetë titulli i esesë është frymëzuar



nga shkrimi i gdhendur satirik në tabelën e një haxhiu holandez, ku "paqja e përhershme" i referohej qetësisë së "varrezave". Natyrisht, ai kurrë nuk dinte për kërcënimet bërthamore. Megjithatë, ka jehonë të frikshme paralajmërimi i tij se "një luftë shfarosëse në të cilën asgjësimi i njëkohshëm i të dyja palëve ... do të lejonte që paqja e përhershme të arrinte vetëm në varrezat e mëdha të racës njerëzore".

Vetë esesa merr formën e një traktati ideal të paqes, që përmban një sërë artikujsh për të arritur jo vetëm te ndërprerja e përkohshme e armiqësive, por deri te fundi i luftës – njëherë e përgjithmonë. Kanti kritikon lehtësinë me të cilën shtetet kontraktajnë borxhin, me qëllim të financimit e luftës. Borxhi, sugjeron ai, është legjitim për projektet paqësore, por kur bëhet fjalë për konfliktet ndërkombëtare, paraja ka "fuqi të rrezikshme" sepse "e kombinuar me prijeten e politikanëve për të luftuar", ajo e "shton lehtësinë për ta bërë këtë".

Paragrafët më të njohur të esesë së Kantit mbi paqen e përhershme, janë ato që sugjerojnë se si të drejtat e kombeve duhet të bazohen në një "federalizëm midis shteteve të lira". Propozimi i Kantit synonte të trajtonte sfidën që mundonte Evropën, pasi dekreti i "paqes së përjetshme" i miratuar në Kuvendin e Vorms [Reichstag zu Worms] në vitin 1495, kishte çuar në ndalimin e grindjeve të zakonshme private në Mesjetë. Cili ishte qëllimi i përdorimit të fuqisë shtrënguese të shtetit për të garantuar paqen e brendshme, nëse siguria e qytetarëve kërcënohej vazhdimisht nga lufta ndërkombëtare? Si duhet të trajtohet lufta midis njësive më të mëdha të cilat tani kishin monopol mbi përdorimin e forcës?

I frymëzuar nga përpjekjet e paraardhësve të vet, duke

përfshirë propozimin e bërë nga Abbé de Saint Pierre për një federatë të shteteve evropiane që përfshin edhe Rusinë, projekti i Kantit ishte ndoshta më ambiciozi. Filozofi prusian këmbënguli se kategoritë standarde të shekullit XVIII për të drejtën private, publike dhe ndërkombëtare, duhet të plotësohen me një të re të cilën ai e quajti "e drejta kozmopolite".

I bazuar në zotërimin e përbashkët fillestar të tokës nga qeniet njerëzore, kozmopolitanizmi i Kantit përfshin njohjen e një "të drejte" për të shkuar kudo – pa u trajtuar me armiqësi. Ai gjithashtu specifikon se meqenëse ndërveprimi global tani ka shkuar aq larg sa që "shkelja e së drejtës në një vend të Tokës ndihet kudo tjetër", koncepti i kozmopolitizmit nuk është çështje etike, por çështje ndërvlarur e drejta private, publike, ndërkombëtare dhe kozmopolite, kur njëra prej tyre vihet në dyshim atëherë shembet edhe pjesa tjetër.

Kanti ishte pacifist, por nuk ishte naiv. Në një ese të njohur të shkruar në vitin 1943, të quajtur E ardhmja e pacifizmit, filozofi britanik Bertrand Russell bëri dallime midis versioneve absolute dhe relative të qëndrimit. I pari, sugjeroi Russell, është argumenti se "në të gjitha rrethanat është gjë e gabuar të marrësh jetën e njeriut". Kjo e fundit, nga ana tjetër, konsiston në qëndrimin se "të këqijat e luftës janë pothuajse gjithmonë më të mëdha sesa duken – për popullsinë entuziaste – në momentin kur lufta shpërthen"; dhe, derisa disa luftëra ia vlenin të bëheshin – në rastet si Lufta e Parë Botërore – "të këqijat që rezultuan" ishin më të mëdha sesa të këqijat e bërjes së lëshimeve të nevojshme për të shmangur luftën.

Sistemi i Kantit reziston ndaj llogaritjeve të këtij lloji: pacifizmi i tij ka të bëjë më shumë me parimet sesa me pasojat.

Megjithatë, si për Kantin ashtu edhe për Russellin, pacifizmi nuk e përbën pozicionin e "kthimit të faqes tjetër" të etërve të hershëm të Kishës, si reagim ndaj së cilës u zhvillua tradita e Luftës së Drejtë. Për avokatët e Luftës së Drejtë, kthimi i faqes tjetër kishte kuptim vetëm në rastin e dhunës ndaj individëve, jo të sulmit si reagim ndaj një grupi të tërë të njerëzve të pafajshëm. Siç shprehet Agustini, kampioni i hershëm i Luftës së Drejtë, "është padrejtësia e palës kundërshtare ajo që njeriut të mençur ia ngarkon detyrën për të bërë luftë të drejtë".

Ky pozicioni ishte po aq i spikatur midis juristëve të shekullit XVIII, po aq sa duket se është midis politikanëve liberalë të shekullit XXI. Në përgjigje të kësaj, lloji i pacifizmit që Kanti propozoi (dhe që frymëzoi Russellin) ishte pjesë e një argumenti politik. Pacifistët janë plotësisht të vetëdijshëm për rreziqet e zbutjes së qëndrimeve [appeasement] dhe për argumentin se qëndrimi pacifist rrezikon të inkurajojë agresionet e mëtejshme. Ajo që përpigën të nxjerrin në pah është rreziku i përshkallëzimit dhe rariteti historik i luftërave të cilat përfundojnë me fitoren totale të vetëm njëres palë.

Esesa e Kantit mbi paqen e përhershme përmendet shpeshherë si frymëzim për Bashkimin Evropian: projekt i lindur nga hiri i Luftës së Dytë Botërore ku ish-armiqtë e përjetshëm u bashkuan në angazhimin e përbashkët ndaj institucioneve paqësore. Me gjithë kufizimet, thelbësore ka qenë jo vetëm që politika e Evropës Perëndimore të largohet nga nacionalizmi vëllavrasës, por edhe që shtetet e zhgënjyera të luftojnë për pajtimin me të kaluarën komuniste.

Kohët e fundit Evropa është bërë vend ku përplasia midis së mirës dhe së keqes kërkohet në mënyrë rutinore për të justifikuar aktet e brutalitetit të papërgjegjshëm, dhe

ku daullet e luftës dëgjoen gjithnjë e më fort. Derisa qeveritë anembanë botës e gjejnë përsëri veten në një garë armatimi, në qiell po shkojnë aksionet e tregut të industrisë ushtarake.

Metaforat luftarake janë kudo: disa i gjejnë te armiqtë brenda kufijve të Evropës, duke nxitur spektrin e kërcënimit të emigrantëve ndaj vlerave tradicionale, ndërkohë që mbrojnë hapur dëbimin e azilkërkuesve jashtë vendit. Të tjerët llogarisin në perspektivën e armiqve të jashtëm, duke na nxitur që të "përgatitemi mendërisht" për një "epokë të paraluftës" – siç paralajmëroi së fundmi kryeministri polak Donald Tusk. Ndërkohë, ata që mbrojnë kompromisin dhe nuancat janë të ekspozuar ndaj talljeve dhe përbuzjeve – në rastin më të mirë – ndërsa në rastin më të keq ndaj censurës dhe shtypjes.

Asgjë nuk shmanget më shumë nga fryma e Kantit, sesa mënyra dogmatike në të cilën na kërkohet ta pranohet luftën në të gjitha format e saj: politike, sociale, kulturore. Ndoshta këtu qëndron rreziku. Ndoshta lufta bëhet në mendje, para se të zbrësë në tokë. Ndoshta bindimi se e mira dhe e keqja janë të dukshme, se e drejta duhet të mbizotërojë dhe e gabuara do të ndëshkohet, se lufta – në botën e ideve, në politikë, në kufijtë tanë, në front – është e vetmja rrugë që kemi para.

Në një botë tjetër të mundshme, do të kisha udhëtuar në Kaliningrad. Do të kisha shkuar, sepse jam dakord me Kantin se të vetmet istikame të cilave duhet t'ju bashkohemi, janë ato të arsyes. Siç insiston njëri prej artikujve të Paqes së përhershme, edhe në mes të ekseleve më të këqija duhet të ruhet njëfarë besimi në humanizmin e armikut. Nëse Kanti ka diçka për të na mësuar 300 vjet pas lindjes së vet, është se kur ndjekja e fitores së plotë rrezikon të çojë në zhdukje të plotë, përshkallëzimi gjithmonë është katastrofë. Përkthimi: Agron SHALA /Telegrafi/

Arkitektura dhe arti i xhamive me kube në Kosovë

Recension i librit të Orges Drançollit, Xhamitë me kube në Kosovë, botim i Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë



Nga: Agron ISLAMI

Këto ditë nga shtypi doli studimi i fundit me titull "Xhamitë me Kube në Kosovë" i historianit të artit, Orges Drançolli, i cili fillimisht është përgatitur si disertacion doktore në Universitetin e Stambolli – në një nga Universitetet më prestigjioze në botë për historinë osmane, përfshirë edhe artin osman.

Vepra e Orges Drançollit është studim monografik që merr në trajtim 11 xhami, monumente me vlera të larta artistike të ndërtuara gjatë periudhës së sundimit osman, 10 prej tyre deri në shek. XVII dhe një në dekadën e tretë të shekullit XIX. Vepra është ndarë në tre kapituj, përfundimin, shtojcën e cila përbëhet nga ilustrimet, bibliografia, burimet arkivore si dhe indeksi i emrave.

Ashtu siç e do tradita, autori librin e fillon me Parathënien, ku ofron të dhëna telegrafike mbi ndërtimet e objekteve arkitektonike me karakter profan në Kosovë, gjatë sundimit osman, siç ishin xhamit, mesxhidet, teqet, çarshit, hanet, karvansarajet, mullinjte, sahat kullat, hamamet, çeshmet etj. objekte të cilat shpërfaqin ndikimin e stilit osman nëpër qytete të Kosovës. Në Hyrje parashtrohen shkurtimisht arsyet dhe motivi që e kanë nxitur për t'u marrë me një studim të tillë, ku evidentohen punimet e pakta të realizuara deri më tani mbi xhamitë klasike dhe neoklasike në Kosovën osmane. Autori tërheq vëmendjen edhe tek artistët dhe arkitektët shqiptarë të cilët krijuan këto vepra arti, të cilat megjithëse i takojnë artit të stilit osman, elementet vendase vërehen në pikturën dekorative të

këtyre xhamive. Por, ky realitet jo gjithëherë është piktuar nga ana e studiuesve, sidomos atyre ndërkombëtarë.

Kapitulli i parë fillon me informacione të përgjithshme të zhvillimit të artit që nga periudhat e hershme e deri tek ajo osmane, e cila karakterizohet me shumëllojshmëri të objekteve sakrale dhe profane të ngritura gjatë këtyre shekujve osman e që, sipas autorit, këto objekte kulturore janë provë materiale e shpirtërore që ndihmojnë të kuptojmë etapat e zhvillimit dhe

të përhapjes së fesë islame te popullsia vendase, si dhe statusin e banorëve vendorë – meqë jo rrallëherë këta të fundit kishin qenë edhe donatorë të objekteve fetare dhe publike. Kështu, analizimi i këtyre objekteve shpërfaq vlerat dhe zhvillimin e artit të stilit osman në Kosovë dhe jo vetëm.

Kapitulli i dytë i është ndarë trajtimit të dëmtimit dhe shkatërrimit të këtyre objekteve nga ana pushteteve pas largimit të administratës osmane. Ky shkatërrim, me qëllim zhdukjen e

këtyre objekteve artistike, u bë në mënyrë sistematike dhe në të shumtën e rasteve në emër të planifikimeve hapësinore e urbanistike, apo edhe nga mos ndjeshmëria e institucioneve komunale ndaj tyre. Por, pa dyshim, shkatërrimet më të mëdha u bënë në luftën e fundit në Kosovë. Në mesin e këtyre objekteve të shumta të shkatërruara nga ana e pushtetit serb, ishin edhe katër xhami me kube të cilat janë marrë në studim nga ana e autorit, siç është Xhamia e Bajrakut në Pejë, Xhamia e Llapit në Prishtinë, Xhamia e Hasan Agës në Rogovë të Hasit, Xhamia e Hadëmit në Gjakovë, si dhe çarshitë e qyteteve në Pejë, Gjakovë, Vushtri etj. Fotografitë e këtyre objekteve e të djegura e shkatërruara janë dhënë në fund të këtij kapitulli dhe dëshmojnë dhe mbështesin të dhënat mbi çështjen e ngritur nga autori. Vlen të theksohet se autori në këtë kapitull ngre shqetësimin e vet në ndërtimet moderne që po bëhen në Kosovën e lirë dhe që këtyre të fundit ju mungon identiteti vendor, respektivisht gjuha që lidh të kaluarën me të tashmen dhe, si shembull i respektimit të kësaj tradite në të kaluarën, përmend objektin monumental të Prishtinës, Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" e cila është e mbuluar me 99 kube të bardha të madhësive të ndryshme që ngjasojnë me kubet e xhamive klasike që gjenden në qytet. Pra, kemi të bëjmë me arkitekturë ku gërshetohet e kaluara me modernen.


Në Kapitullin e tretë i cili përbën temën bosht të monografisë, trajtohen njëmbëdhjetë xhami të mbuluara me kube. Për secilin

objekt, autori ndalet në historikun, karakteristikat arkitektonike, karakteristikat dekorative, si dhe gjendjen e tanishme të objekteve. Autori objektet i trajton nga prizmi i historisë së artit. Si burim kryesor për realizimin e studimit kanë qenë vetë objektet. Kësisoj, autori faton gjendjen ekzistuese të objektit fetar. Po ashtu, studimet i plotëson me literaturën primare dhe sekondare që është botuar nga autorë të huaj dhe vendorë për secilin monument që trajtohet në këtë vepër. Xhamitë shoqërohen me paraqitjet teknike si dhe fotografitë e realizuar me iniciativën e vetë autorit.

Në përfundim, autori bënë përmblendhjen dhe jep karakteristikat e përgjithshme të xhamive klasike me kube në Kosovë. Po ashtu, ndalet në stilin e ndërtimit, aspektet planimetrike, konstruktive e artistike. Për më shumë, bënë krahasime me xhamitë e tjera të rajonit. Njëherësh, autori prezanton dhe jep vlerësim të përgjithshme në lidhje me këto monumente sakrale njëhapësinore, gjë që shpërfaq kompetencën profesionale mbi tematikën e shtruar në këtë libër. Ajo që e bënë edhe më të veçantë për nga vlera shkencore këtë vepër, janë ilustrimet, respektivisht paraqitjet grafike mbi planimetrinë e xhamive të cilat janë trajtuar në këtë vepër.

Marrë parasysh faktin se vepra e fundit e autorit Orges Drançolli është studimi i parë që merr në trajtim xhamitë me kube në Kosovë, kjo përbën një kontribut të veçantë për artin e stilit osman, sikur edhe një model të mirë për studiuesit e rinj të cilët duan të merren me këtë lëmi. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot mësohen finalistet e Kupës në futboll

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 PRILL - Sot (e mërkurë) do të zhvillohen dy ndeshjet kthyesë në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll, me ç'rast do të mësohen edhe dy skuadrat finaliste në këtë garë mjaft të rëndësishme në futbollin e Kosovës.

Vëmendja kryesore do të jetë në derbin në mes të Dritës dhe Prishtinës. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Lipjan këto dy skuadra luajtën baras 0-0, derisa sot në Gjiilan që të dyja do ta synojnë fitoren dhe kualifikimin në finalen e madhe, më pas edhe triumfin që siguron daljen në garat evropiane. Sa i përket kampionatit, Drita është më mirë pasi ende po lufton për titull, ndërsa Prishtina e ka humbur hapin dhe objektivi të vetëm e ka garën e Kupës.

Ndeshjen e së mërkurës FC Prishtina e ka konsideruar si më të rëndësishmen në këtë edicion garash. Ndërsa sa i përket rezultatit 0-0 nga ndeshja e parë, vlerëson se nuk lejon kalkulime në ndeshjen kthyesë. "Skuadra zhvillon ndeshjen më të rëndësishme deri më tani në këtë edicion. Rezultati i ndeshjes së parë pa gola detyron skuadrat të luajnë pa shumë kalkulime në këtë përballje të dytë ku fitorja në 90 minutat e rregullt, me çfarëdo rezultati, dërgon në finale, ndërsa çdo barazim në pjesën e rregullt dërgon duelin në shtesa, apo në fund në penallti. Skuadra në



fundjavë ka arritur fitore në kampionat duke ngritur vetëbesimin dhe duke forcuar besimin se mund t'ia dalë të kualifikohet në finalen e 12 në histori të klubit", thuhet në postimin e Prishtinës.

Në ndeshjen tjetër gjysmëfinale do të përballen Ballkani dhe

Suhareka, një derbi i skuadrave nga i njëjti qytet. Ndeshjen e parë të zhvilluar e kanë fituar kampionët në fuqi të Superligës me rezultat 0-1. Tash Suhareka do të mundohet ta befasojë Ballkanin dhe të kualifikohet në finale. Të dyja ndeshjet zhvillohen nga ora 15:00.

Ylli - Peja, sonte përballja e dytë e 'play-off'-it

PRISHTINË, 23 PRILL - Mesjava do të sjellë përballjet e dyta gjysmëfinale të "play-off"-it në Prince Caffè Superligë. Gara sa vjen bëhet më interesante dhe vendimtare, ku katër skuadra luftojnë për titullin e kampionit. Golden Eagle Ylli-Peja është sfida që zhvillohet të mërkurën mbrëma. Therandasit fituan ndeshjen e parë si mysafirë 84:87, në një takim me kthesa dhe tani Ylli avancoi në serinë gjysmëfinale 1:0. Vendasit synojnë të ngritin epërsinë në 2:0 dhe të afrohen më shumë drejt finales, kurse kampionët të barazojnë serinë në 1:1 dhe ta rikthejnë epërsinë e terrenit vendas. Dueli tjetër zhvillohet të enjten mes Sigal Prishtinës dhe Trepçës. Duelin e



parë e fituan mitrovicasit 87:81 dhe synojnë fitoren e dytë radhazi në gjysmëfinale, kurse prishtinasit synojnë ta barazojnë serinë në 1:1.

Skuadrat që shënojnë tri fitore do të kualifikohen në finale, ndërsa për t'u shpallur kampionë nevojiten tri fitore.

SHKURT

Donjeta Sadiku dhe vëllezërit Shpëtim dhe Bashkim Bajoku vazhdojnë përgatitjet

Boksierja Donjeta Sadiku, e cila ka fituar normën Olimpikë, po vazhdon përgatitjet në Durrës. Atje ajo do të qëndrojë 12 ditë, pastaj do të vazhdojë përgatitjet në kampe të ndryshme ndërkombëtare që ta ruajë formën dhe të jetë sa më e përgatitur për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Kështu ka njoftuar Federata e Boksit e Kosovës me një komunikatë. "Ndërsa vëllezërit Bajoku gjenden në përgatitje në Ferizaj, dhe nga 1 maj do të vazhdojnë me përgatitje në kampe të ndryshme ndërkombëtare. Këto përgatitje janë të mirëseardhura për vëllezërit Bajoku para turneut botëror kualifikues për Lojërat Olimpikë Parisi 2024, që do të mbahen nga 26 maj - 02 qershor në Bankok (Tajlandë)", thuhet në njoftim e Federatës së Boksit.

Gjyqtarët e basketbollit nga Kosova do të gjykojnë në garat evropiane

Gjyqtarët nga Kosova do të gjykojnë në garat evropiane që do të zhvillohen gjatë verës. Xhelal Mumini do të gjykojë në FIBA U20 EuroBasket Division B për meshkuj, që do të zhvillohet në Pitesti të Rumanisë. Ky kampionat zhvillohet nga 12 deri më 21 korrik. Ngadhnjim Shabani do të gjykojë në FIBA U18 EuroBasket Division B për meshkuj, që zhvillohet në Shkup të Maqedonisë Veriore nga 26 korriku deri më 4 gusht. Elldin Uglari do të gjykojë në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla që zhvillohet në Prishtinë nga 25 deri më 30 qershor. Uglari, po ashtu, do të gjykojë në U16 Women's EuroBasket, Division B që zhvillohet nga 15 deri më 24 gusht në Konja të Turqisë. Amar Djekoviç do të gjykojë në dy gara ndërkombëtare. Amari do të gjykojë në FIBA Kampionatin Evropian për U18 Femra, Divizioni C, që zhvillohet në Prishtinë nga 23 deri më 28 korrik, si dhe FIBA U16 EuroBasket Division C, që zhvillohet në Tiranë nga 9 deri më 14 korrik.

Presidenti Ademi dhe kryetari i Laposaviqit nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe humanisti Halil Kastrati, së bashku me bashkëpunëtorë, kanë qëndruar në Laposaviq, ku u pritën nga kryetari i kësaj komune, Lulzim Hetemi. Në një atmosferë të ngrohtë e miqësore, presidenti Ademi dhe kryetari Hetemi kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit, i cili parasheh rregullimin e kompleksit sportiv dhe fushës së futbollit në këtë komunë. Kjo iniciativë shënon një hap të rëndësishëm drejt promovimit të sportit dhe aktiviteteve të ndryshme shoqërore në këtë komunë, e cila për shumë vjet nuk ka pasur investime në sport. Presidenti Ademi ritheksoi edhe një herë se FFK-ja i ka dyert e hapura për regjistrimin në gara për të gjitha klubet në të gjithë territorin e Republikës, duke përfshirë edhe ato nga Laposaviqi ku u nënshkrua memorandumi. Ndërkaq, humanisti i njohur Halil Kastrati sigurisht do të bëjë mrekulli edhe në komunën e Laposaviqit me projekte, siç ka bërë edhe në të gjitha komunat e Kosovës e më gjerë. Bashkëpunimi mes autoriteteve lokale dhe FFK-së është thelbësor për zhvillimin dhe përparimin e komunitetit të futbollit, andaj nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit do të sjellë fryte për të rinjtë e kësaj treve, duke nxitur bashkëjetesën në paqe përmes sportit.

Rrahmani në 'radarin' e Werder Bremenit

BREMEN, 23 PRILL - Werder Bremen ia ka vënë syrin sulmuesit të Rapid Bukureshtit, Albion Rrahmani, raporton portali gjerman "Liga Insider". Rrahmani po kalon një sezon historik të "Giulesti", pasi ka luajtur 20 ndeshje dhe ka

shënuar 18 gola e ka dhuruar katër asistime vendimtare. Çmimi i reprezentuesit të Kosovës është afërsisht 2 deri në 3 milionë euro, sipas faqeve të specializuara të internetit. "SV Werder Bremen duket se e ka gjetur atë që kërkon në Rumani. Në

kërkim të një sulmuesi të ri, Albion Rrahmani nga FC Rapid Bukuresht konsiderohet kandidat për ekipin gjerman", shkruan mediumi gjerman. Skautët e Bremenit thuhet se monitoruan lojtarin në ndeshjen e tij të fundit në

stadium për të marrë një pamje më të qartë të tij. Megjithatë, sipas raportit, bisedimet mes klubeve ende nuk kanë filluar. Bremenit do të përballet me konkurrencën nga Republika Çeke: SK Slavia Prague gjithashtu duket se është e interesuar për



nënshkrimin e tij, madje ka dorëzuar një ofertë zyrtare, e cila i është refuzuar.

Inzaghi pas fitimit të 'Scudetos': Është një sensacion i jashtëzakonshëm

MILANO, 23 PRILL - Simone Inzaghi ka zbuluar se ndihet i lumtur me suksesin e tij tek Interi, teksa meritat e trofeut ia dha gjithë skuadrës dhe drejtuesve. Trajneri italian kishte marrë gjithmonë trofe që kur erdhi te "nerazzurrët" në vitin 2021, por ky ishte titulli i parë i Serisë A në karrierën e tij. Ai u arrit në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mposhtur rivalët e Milanit në "Derby della Madonnina", për më tepër në atë që ishte zyrtarisht një ndeshje në "shtëpinë" e kuqezinjve. "Është një sensacion i jashtëzakonshëm. Ne bëmë diçka të pabesueshme dhe është e drejtë ta ndajmë atë me sa më shumë njerëz të jetë e mundur", ka thënë Inzaghi për DAZN.

"Ka qark shumë protagonistë të këtij suksesi, në radhë të parë lojtarët, por edhe drejtorët dhe presidenti Steven Zhang, pasi çdo gjë që na nevojitej gjatë këtij rrugëtimi na u siguroi. Është e qartë se mendimet e mia shkojnë edhe te familja ime, gruaja ime Gaia, fëmijët e mi, prindërit e mi. Kufizimi im është se shpesh nuk mund ta lë punën time dhe prirjen ta sjell me vete në shtëpi, por ato ishin thelbësore për mua", ka shtuar



Inzaghi. Goditja me kokë e Francesco Acerbit dhe një gol i Marcus Thuram rezultuan vendimtarë pavarësisht golit të Fikayo Tomorit dhe fundit të tensionuar me kartonët e kuq për Denzel Dumfries, Theo Hernandez dhe Davide Calabria. "Ishte një lojë e mirë. Është për të ardhur keq që u tensionua në pesë minutat e fundit, pasi deri atëherë ishte shumë e drejtë. Luajtëm mirë, mund të kishim shënuar edhe një gol në pjesën e parë, por jemi shumë të lumtur", ka pohuar ai. Inzaghi ka fituar gjashtë trofe tani në Inter, trajneri i tyre i tretë më i

suksesshëm që nga themelimi i Serisë A moderne më 1929-30, pas Helenio Herreras dhe Roberto Mançinit me nga shtatë secili. "Ishte një rrugëtimi i gjatë për mua dhe stafin tim. Ju punoni çdo ditë duke u përpjekur të përmirësoheni. Nëse mendoj për ndeshjet e mia debutuese në Ligën e Kampionëve këtu me Real Madridin dhe Liverpoolin, të cilët vazhduan të ishin finalistët atë vit, unë tashmë mund t'i shihja shenjat pozitive dhe isha i sigurt se mund të ndërtonim mbi atë për të vazhduar dhe për të arritur gjashtë trofe", ka përfunduar trajneri italian.

Denveri mposht lakersat në sekondën e fundit, triumfojnë edhe Clevelandi dhe New Yorku

DENVER, 23 PRILL - Një kosh në sekondën e fundit nga ana e Murrayt i dha fitoren ekipit të Denverit, që mundi me rezultat 101-99 lakersat në çerekfinalen e dytë "play-off", duke udhëhequr 2-0 serinë. Një sfidë e ekuilibruar, që mund të ishte fituar edhe nga miqtë. Trioja Davis-James-Russell realizoi 81 pikë për lakersat, por që s'mjaftuan për të fituar. Për kampionët e Denverit, Jokiç realizoi



një "triple double" me 27 pikë, 20 rebounde dhe 10 asistime, mbështetur nga Porter me 22 pikë e Murray me 20. Në Konferencën e Lindjes, ekipi i Clevelandit mundi me shifrat 96-86 Orlandon dhe tashmë udhëheq 2-0 serinë e çerekfinaleve. Donovan Mitchell me 23 pikë ishte lider në fushë për Cavaliersin, që meritoi fitoren. Po 2-0

udhëheq serinë e takimeve çerekfinale edhe ekipi i New Yorkut, që mposhti me rezultat 104-101 Philadelphian. Sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për vendasit të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë (Brunson 24 më i miri). Embiid e Maxey realizuan 69 pikë për Philadelphian, por që mbetën për statistikë.

ÇERKFINALET - KONFERENCËS SË LINDJES

Cleveland - Orlando	96-86 (2-0)
New York - Philadelphia	104-101 (2-0)
Boston - Miami	(1-0)
Milwaukee - Indiana	(1-0)

ÇERKFINALET - KONFERENCËS SË PERËNDIMIT

Minnesota - Phoenix	(1-0)
Denver - Lakers	101-99 (2-0)
Clippers - Dallas	(1-0)
Oklahoma - New Orleans	(1-0)

Emery rinovon kontratën me Aston Villan

Trajneri Unai Emery mbetet tek Aston Villa. Trajneri spanjoll është një nga faktorët kryesorë shtytës pas periudhës së shkëlqyer dyvjeçare që po përjeton klubi nga

Birminghami. Sipas asaj që raportohet nga "The Athletic", ai tashmë ka rinovuar kontratën deri më 30 qershor 2027 me klubin që aktualisht ndodhet në vendin e katërt të Premierë

Ligës dhe me të cilin ka arritur në të njëjtën kohë edhe në gjysmëfinale të Ligës së Konferencës. Në vizionin e pronarëve të klubit, Emery duhet të bëhet versioni i tyre i

krijuar në Birminghami të asaj që bëri Sir Alex Ferguson në kohën e tij te Manchester Unitedi. Me pak fjalë, Aston Villa ka çdo synim ta mbajë trajnerin që i ktheu në Evropë për sa më

shumë që të jetë e mundur. Nga ana e tij, vetë trajneri do ta kishte vlerësuar gjithmonë hapësirën e gjerë të manovrimit që klubi anglez i lejoi të kishte që nga momenti i mbërritjes.

SHKURT

Kosova U18 në Kampionatin Mesdhetar në Turqi

Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll (meshkujt) do të ketë një tjetër kampionat të rëndësishëm e sfidues. Prej 5 deri më 12 maj në Ankara të Turqisë, Kombëtarja jonë do të paraqitet në Kampionatin Mesdhetar. Është ky Mesdhetari i 20-të rresht për hendbollistët e rinj. Kosovën U18 e presin ndeshje të forta, që do të shërbejnë për rritjen e mëtejme të kësaj gjenerate premtuese. Kroacia, Franca, Iraku, Mali i Zi, Maroku, Rumania, Tunizia e Turqia janë kombëtares të tjera pjesëmarrëse. Kombëtares do të ndahen në dy grupe, ndërsa pas fazës grupore do të ketë ndeshje për plasman përfundimtar. Pra programi do të jetë shumë i ngarkuar. Në muajin gusht, Kosova U18 do të paraqitet në Kampionatin Evropian që mbahet në Prishtinë.

Asllani shpallet kampion me Interin: Nuk ka fjalë që e përshkruan gëzimin

Interi festoi titullin e 20 në Serinë A. pjesë e saj ishte sigurisht edhe futbollisti shqiptar Kristjan Asllani. Futbollisti i Kombëtares Shqiptare po përjeton një moment magjik. "Jemi shumë të lumtur. Nuk ka fjalë që e përshkruan. Si tifoz i Interit nuk mund të kërkoja asgjë më të mirë. Jemi të lumtur. Edhe sot ishim larg shtëpisë, por kishte shumë tifozë. Ndoshta ende nuk e kam kuptuar që e kemi fituar këtë kampionat. Do të shohim nesër në mëngjes. Fitorja në derbi ndoshta ka edhe më shumë rëndësi. Ne e donim 'Scudeton'. Ia dolëm. Tani le të vazhdojmë", ka deklaruar Asllani.

E ardhmja e Sainzit është ende e paqartë

E ardhmja e pilotit spanjoll Carlos Sainz është ende e paqartë. Ai do ta lërë skuadrën Ferrari në fund të këtij viti, për t'i lënë vendin Lewis Hamiltonit. Ish-kampioni i botës në Formula 1, Nico Rosberg, ka zbuluar disa prapaskena në lidhje me të ardhmen e Carlos Sainzit. "Sainz do të ishte zgjidhja më e mirë për Mercedesin, por edhe për Red Bullin. Di se Red Bull nuk i ofroi atij shumë para dhe Mercedesi nuk dëshiron t'i ofrojë atij më shumë se një vit kontratë, sepse shpreson për Kimi Antonellin, i cili është vërtet i jashtëzakonshëm", ka thënë Rosbergu. "Carlos do të ishte perfekt për Sauber/Audi, por a do të ishte Sauber/Audi perfekt për të? Sainzi do të fitojë gara dhe atje do t'i duhej të fillonte nga e para. Vendimi do të jetë shumë i vështirë", u shpreh Rosbergu, që mendon se këto tri makina janë ato që kërkojnë me ngulm spanjollin.

Mourinho mund të jetë zëvendësues i Kloppit në Liverpool

Ta zëvendësosh Jurgen Kloppin nuk është aspak e lehtë, trashëgimia që tekniku gjerman ka lënë në Liverpool është shumë e madhe, por tifozët e kanë një emër. Jose Mourinho është një nga dëshirat e tyre më të mëdha. Kjo është ndezur edhe më shumë pas sfidës Fulham - Liverpool, ku tekniku portugez ishte i pranishëm në shkallet e stadiumit. Sigurisht, ta shohësh Mourinhon në stolin e Liverpoolit nuk është e lehtë, një trajner që për shumë vite ka qenë rivali më i madh i të kuqeve, teksa në karrierën e tij ka drejtuar ekipe si Chelsea, Manchester United dhe Tottenham. Mourinho nuk do të ishte kundër këtij opsioni, kurse Liverpooli është një emër i madh, një skuadër e mbushur me yje, një opsion i shkëlqyer për t'u rikthyer në futbollin e madh në fund të këtij sezoni.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ali Shabani nga Godanci - Shtime shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Filozofik dega Histori të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

- Astrit Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Alban Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë prej klasës 1-8 të shkollës fillore "Selman Riza", Gjakovë.

- Fatlinda Gjuraq nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.

- Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K . "11 Marsi" Prizren.

- Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi " Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektroteknik.

- Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. " Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

